



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.336/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesuese, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt ankesa e Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë e datës 22.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me të cilën ka pretenduar se kandidati i AAK-së , Mervan Isufi në rrjetin social facebook me datën 22 tetor 2017 rreh orës 10 ka shperndare nje fotografi të tijën me logon dhe numrin e partisë dhe me numrin e kandidatit per asamble komunale, si dhe fotografia e kandidatit Faton Jakupi. Parahstruesi i ankesës thekson se eshte bere shkelaj e nenit 36.1 pika b) të LZP-së
Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e BIRN dhe Internews Kosova është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërsënuar e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr.336/2017 më datën 22.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.